



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2018

Drejtuar: Operatorit ekonomik "Tower" shpk

Adresa: Rruga "Fadil Rada", Pallati Daniela, Shkalla 2, Kati i III, Ap. 9. Njësia Administrative Nr.2. Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim" "Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2018", të ndarë në lote.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-82464-08-08-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: Loti i parë: "Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rikualifikimi urban i bllokut kufizuar nga Rruga "Ded Gjon Luli" - BLV "Zogu Parë" - "Mine Peza" dhe rikonstruksioni i Rrugës "Prokop Myzeqari" dhe Rrugës "Hamid Shijaku".

Fondi limit në total: 1,197,900 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.

Fondi limit Loti i parë: 978,380 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 132 datë 21.12.2017, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018".

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 8 (tetë) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 20.08.2018, ora 11:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32 datë 13.08.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “ Tower "shpk

NUIS L21717003H

Vlera e ofertës = **845,808.33** (tetëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tetë pikë tridhjetë e tre lekë pa TVSH.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “ Rean 95 "shpk

NUIS J61827043V

Vlera e ofertës = **891,304** (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e katër) lekë pa TVSH.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Dricons” shpk

NUIS L52013020H

Vlera e ofertës = **845,808** (tetëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk

NUIS L01717030C

Vlera e ofertës = **844,970** (tetëqind e dyzet e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tirana New Supervisor” shpk & “Vler Invest” shpk

NUIS L21311040P

NUIS K81721022P

Vlera e ofertës = **845,811.67** (tetëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Ersi M” shpk

NUIS J98624803O

Vlera e ofertës = **870,758** (tetëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

7. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ M.A.K Studio “

NUIS

L01422017O

Vlera e ofertës = **853,147** (tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.

Operatorët ekonomik të skualifikuar janë:

- Operatori ekonomik “Dricons” shpk
- Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tirana Neë Supervisor” shpk & “Vler Invest” shpk
- Operatori ekonomik “Ersi M” shpk
- Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Dricons” shpk

NUIS L52013020H

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik, nga ku rezultoi se:

-Operatori ekonomik nuk ploteson piken 3 te Kriteve te Vecanta te kualifikimit:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij inxhinierë të licensuar për kategoritë e kërkuara, të vertetuar me License profesionale të shoqërisë ose License Individuale, kontrate pune të vlefshme, diplome, CV, Libreze Pune dhe të figurojë në Listpagesat e Shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit"

pasi për ing. gjeodet z. Hajri Hamdi Domi dhe ing. Hidroteknik Zyber Koseni **ka paraqitur një kopje diplome të panoterizuar dhe të pa shoqëruar me vertetimin e Njesisë së Kopjes me origjinalin.** Mbi këto diplome figuron një vulë noteriale e cila nuk përkon me vulën noteriale të noterit që ka nënshkruar kontratën e punës bashkëngjitur këtij dokumenti. Si rrjedhojë referuar paragrafit të fundit të Shtojcës 7 të DST:

"Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme dhe të pasakta, konsiderohet si kusht për skualifikim"

--Operatori ekonomik nuk ploteson piken 3 te Kriteve te Vecanta te kualifikimit:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij inxhinierë të licensuar për kategoritë e kërkuara, të vertetuar me License profesionale të shoqërisë ose License Individuale, kontrate pune të vlefshme, diplome, CV, Libreze Pune dhe të figurojë në Listpagesat e Shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit"

pasi për ing. elektrik z. Anatol Stefan Gjata **ka paraqitur një kopje diplome të panoterizuar dhe të pa shoqëruar me vertetimin e Njesisë së Kopjes me origjinalin.** Si rrjedhojë referuar paragrafit të fundit të Shtojcës 7 të DST:

"Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme dhe të pasakta,

konsiderohet si kusht per skualifikim"

2. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "Novatech Studio" shpk

NUIS

L01717030C

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik, nga **nga ku rezultoi se:**

- Operatori ekonomik "Novatech" shpk, nuk ka respektuar VKM Nr. 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", cituar ne paragrafin e fundit te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Kjo Bazuar ne njoftimin e bere me Nr. 5585 date 25.07.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te Specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", si dhe njoftimit Nr. Prot 13565 date 06.11.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Terheqje Vemendje", ku kerkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nenligjore dhe VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".

Sa me siper u Konstatua se Vlera e ofertes ekonomike te ofertuar nga Operatori Ekonomik nuk eshte ne perputhje me VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" pasi eshte me e ulet se vlera minimale e perlogaritur nga Autoriteti Kontraktor, per kete procedure.

Bazuar ne Rekomandimin e APP-se Nr. 5585 date 25.07.2017 "Mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim, pika 2, Shprehimisht thuhet se:

Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat mund te jene me ultra se sa normat minimale, te specifikuara nga ky manual"

Ne rastin kur operatori ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanen e jashtezakonshme, Autoriteti Kontraktor gjate vleresimit te ofertes duhet ti referohet vleres minimale te perlogaritur per kete procedure prokurimi ne baze te parashikimit te VKM Nr. 354 date 11.05.2017 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim"

Ne rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nese ndodhet ne rrethana te jashtezakonshme per proceduren e prokurimit me objekt: **Loti i Parë:** "Mbikqyrja e Punimeve per objektin "Rikualifikim Urban i bllokut kufizuar nga

rruga "Ded Gjo Luli" - "BLV Zogu Pare" - "Mine Peza" - dhe rikonstruksioni i rruges "Prokop Myzeqari" dhe rruges "Hamdi Shijaku".

Per sa me siper theksojme se eshte detyre e operatorit ekonomik te garantoje qe oferta e paraqitur te jete ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi si rrjedhoje konkudojme se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "Novatech" shpk, nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Respektim te VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".

- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti Teknik Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **391,352** (treqind e nentëdhjetë e nje mije e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

8. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera lidhur me zbatimin e punimeve dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.

pasi nuk ploteson vleren prej 40% te punimeve te ngjashme.

3. **Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Tirana Neë Supervisor" shpk & "Vler Invest" shpk**

NUIS L21311040P
NUIS K81721022P

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik, nga nga ku rezultoi se:

--Operatori ekonomik nuk ploteson piken 3 te Krieterve te Vecanta te Kualifikimit:

Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kete ne stafin e tij inxhinier te licensuar per kategorite e kerkuara, te vertetuar me License profesionale te shoqerise ose License Individuale, kontrate pune te vlefshme, diplome, CV, Libreze Pune dhe te figuroje ne Listpagesat e Shoqerise per te pakten 6 muajt e fundit"

pasi per ing. Bashkim Sali, Engjell Cici, dhe Gjergji Sotiri **ka paraqitur nje kopje diplome te panoterizuar dhe te pa shoqeruar me vertetimin e Njesise se Kopjes me originalin.**

Kjo referuar paragrafit te fundit te Shtojces 7 te DST:

"Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme dhe te pasakta, konsiderohet si kusht per skualifikim"

4. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "Ersi M" shpk

NUIS J986248030

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik, nga ku rezultoi se:

- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 4 b te Kriteve te Vecanta te kualifikimit:

4. Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjete) personave, për periudhën Janar 2018 – Qershor 2018 të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Janar 2018 –Dhjetor 2018**.
- b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen **Janar 2018 –Dhjetor 2018 shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.**

pasi nuk ka paraqitur formularet e deklarimit te pagesave per periudhen e kerkuar

5. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "M.A.K Studio" shpk.

NUIS L014220170

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga B.O.E Operatori Ekonomik, nga ku rezultoi se:

--Operatori ekonomik nuk ploteson piken 3 te Kriteve te Vecanta te kualifikimit:

Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kete ne stafin e tij inxhinere te licensuar per kategorie e kerkuara, te vertetuar me License profesionale te shoqerise ose License Individuale, kontrate pune te vlefshme, diplome, CV, Libreze Pune dhe te figuroje ne Listpagesat e Shoqerise per te pakten 6 muajt e fundit"

pasi **ka paraqitur nje kopje te dokumentave te diplomave dhe librezave te punes te pa shoqëruar me vërtetimin e Njesise se Kopjes me origjinalin.** Kjo referuar paragrafit te fundit te Shtojces 7 te DST:

"Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme dhe te pasakta,

konsiderohet si kusht per skualifikim".

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë Operatorin ekonomik **“Tower” shpk me adresë: Rruga “Fadil Rada”, Pallati Daniela, Shkalla 2, Kati i III, Ap. 9. Njësia Administrative Nr.2. Tiranë** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **845,808.33** (tetëqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skënderbej”, Nr. 2, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.**

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do ndiqet procedura siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **24/08/2018.**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.



Kryetari

Erion Veliaj

Njësia e prokurimit:

Entela Kruja

Ardit Bedhia

Ergys Çela

Miratoi:

Julian Zanaj, Drejtor i Prokurimeve